VENDIM
Nr.68, datë 1.10.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HYDROENERGY" SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "a", 9 dhe 13 pika 1, germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "a" dhe 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hydroenergy" sh.p.k., për t'u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1).
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).
- Lejes së përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Ishëm-Erzen.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Lidhjen me sistemin (neni 9, pika 4.1.5.a) dhe lejen e mjedisit (neni 9, pika 4.1.5.c), është shoqëruar nga informacioni se aplikuesi është ende në procesin e marrjes dhe miratimit të këtyre dy dokumenteve në institucionet përkatëse.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë "Hydroenergy" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta